

## KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Në Tiranë sot më datë 04.05.2020, po lidhet kjo Kontratë për Shitje Kuotash ndërmjet palëve si më poshtë:

### SHITËSI

**Z. Ilir Daci**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, në Shqipëri, më 05.08.1980, mbajtës i kartës së identitetit nr. 034517807, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, banues në Tiranë.

dhe

### BLERËSI

**Z. Glon Bakalli**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 10.08.1977, mbajtës i pasaportës nr. BD6460367, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, banues në Tiranë.

Këtej e tutje “Shitësi” dhe “Blerësi”, bashkërisht do të quhen “Palët” dhe individualisht secili prej tyre mund të quhet edhe “Pala”.

### Meqenëse

- A. Shitësi është ortak tek shoqëria PIK Creative Shpk, një shoqëri e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik identifikimi të biznesit me NUIS L12316016A, me kapital në total në shumën 100 (një qind) Lekë.
- B. Shitësi, duke qenë zotërues dhe përfitues ligjor i 40% të totalit të kapitalit shoqëror të PIK Creative dëshiron të shesë 20% të pjesëmarrjes së tij në total në kapitalin e shoqërisë të PIK Creative (“Kuota e Shitjes”), në mënyrën e parashikuar në këtë Kontrate dhe Blerësi dëshiron të blejë dhe zotërojë Kuotën e Shitjes nga Shitësi, të lirë nga çfarëdolloj barre siguruese dhe bashkë me të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat e ndryshëm, në kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë Kontrate.
- C. Palët dëshirojnë të lidhin këtë Kontrate për të përcaktuar kushtet dhe afatet e rëna dakord ndërmjet tyre për shitblerjen e Kuotës së Shitjes nga Shitësi tek Blerësi dhe të të drejtave dhe detyrimeve të Palëve.

Palët bien dakord si më poshtë:

## **Neni 1 Objekti i Kontratës**

**1.1** Blerësi bie dakord të blejë dhe Shitësi bie dakord ti shesë Blerësit, Kuotën e Shitjes të lirë dhe pa asnjë lloj barre, së bashku me të gjitha të drejtat, titujt, interesat dhe përfitimet që i përkasin kësaj kuote.

**1.2** Kuota do të transferohen menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate nga Shitësi tek Blerësi dhe Blerësi do të bëhet pronar me të drejta të plota i 1 (një) kuote në kapitalin e Shoqërisë.

## **Neni 2 Çmimi i Shitjes**

**2.1** Çmimi i shitjes së Kuotës përfaqëson vlerën nominale të Kuotës dhe palët bien dakord që ky çmim të jetë në shumën prej 20,00 lekë (më poshtë quajtur “**Çmimi i Shitjes**”).

**2.2** Palët pranojnë që Çmimi i Shitjes është paguar dhe Shitësi nuk ka asnjë pretendim finansiar ndaj Blerësit tanë dhe/ose në të ardhmen kundrejt Blerësit.

## **Neni 3 Deklarime dhe Garanci**

**3.1** Shitësi nëpërmjet kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Blerësin se:

- ka zotësi të plotë ligjore dhe zotëron të gjitha kompetencat në lidhje me nënshkrimin, dorëzimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje si dhe në lidhje me kryerjen e transaksionit të parashikuar në këtë Marrëveshje
- Shitësi zotëron Kuotat të lira nga çdo hua, hipoteke, barre siguruese, peng, marrëveshje kufizuese, kufizim të drejte transferimi apo marrëveshje për kufizimin e të drejtës së votës.

## **Neni 4 Përgjegjësia e Shitësit**

**4.1** Shitësi është përgjegjës për çdo dëm të ndodhur në rast se deklarimet dhe garancitë e parashikuara në nenin 3 me sipër rezultojnë të pavërteta.

## **Neni 5 Të ndryshme**

**5.1** Kjo Kontratë zbatohet dhe interpretohet sipas legjisacionit shqiptar në fuqi. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me këtë Kontratë do të zgjidhet nga Palët me mirëkuptim dhe në rast të kundërt, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

**5.2** Kjo Kontratë përbën mirëkuptimin e plotë të palëve si dhe deklarimet e plota dhe ekskluzive të kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë në lidhje me objektin e saj. Kjo Kontratë zëvendëson të gjithë marrëveshjet apo mirëkuptimet e mëparshme, me shkrim apo me gojë, që mund të ekzistojnë midis palëve lidhur me objektin e kësaj Kontrate apo pjesë në total të saj.


2

**5.3** Nëse secila prej dispozitave të kësaj Kontrate është apo do të bëhet e pavlefshme, pjesërisht apo tërësisht, vlefshmëria dhe legjimiteti i dispozitave të tjera mbetet i pacenuar. Dispozitat e pavlefshme, në masën e lejuar me ligj, do të zëvendësohen me dispozita të tjera të vlefshme dhe të zbatueshme, të cilat duhet të janë në përputhje me synimin dhe qëllimin ekonomik të dispozitave që zëvendësojnë, të cilat janë të pavlefshme e të pazbatueshme.

**5.4** Kjo Kontratë hartohet në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secili. Nga një ekzemplar i jepet secilës Palë, një ekzemplar depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**SHITËSI**

Z. Ilir Daci



**BLERËSI**

Z. Glon Bakalli

